SHABAN ÇUPI

ELABORATI MILLOSHEVIQIAN

MAGJET E ZBRAZËTA

TË MPOSHTET ME SOLIDARITET POPULLOR

BULETINI NR.4, DHJETOR, 1991

Historiku i një shkrimi dhe mesazhi i tij

Kishte vite e dekada që Kosova përjetonte një shtypje të thellë nga pushtuesi serb. Kjo shtypje jo vetëm që nuk zvogëlohej, por ajo në vazhdimësi rritej dhe represioni bëhej gjithnjë e më i padurueshëm. Format e zullumit ishin të shumëllojta. Krahas burgosjeve e torturave, ndjekjeve e persekutimeve, gjatë vitit 1990, e këtej, pushtuesi serb largoi nga puna të gjithë punëtorët shqiptar. Si përjetues i atyre situatave, konstatojmë se këto masa që i ndërmori armiku ishin tejet të rënda sepse në popull u krijua një varfëri e madhe e për pasojë shumë kush mori rrugën e gurbetit. Zaten këtu ishte edhe qëllimi i pushtesit serb, që me copë buke ta gjunjëzoj shqiptarin dhe se në mes të bukës dhe lirisë, ai do të zgjedhë të parën, pra bukën. Kështu ishte plani armik.

Megjithate, koha e dëshmoi se i tërë ky projekt antishqiptarë u mposht me solidaritet popullor dhe për të risjellur sodo pak ngjarjet e para 35 viteve, po ribotojmë shkrimin tim në tërësi:

Elaborati millosheviqian ,,Magjet e zbrazëta'' të mposhtet me solidaritet popullor të botuar në fletushkën ,,Buletini'' nr.4, dhjetor 1991

Po kush ishte **Buletini** dhe ku botohej?

Buletini ishte një organ informativ i Degës së Forumit Rinor të LDK-së në Han të Elezit dhe numri i parë u botua më 7 shtator 1991.

Qëllimi themelor i Buletinit ishte që të informoj opinion e trevës me ngjarjet që po ndodhnin, aktivitetin e forumit dhe reprezaljet që i bënte pushtuesi mbi popullatën shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe, arritëm t`i nxerrnim dy fletushka: Buletinin si organ informativ i

Forumit Rinor të degës së LDK-së dhe Bashkimin Kombëtar, organ i Grupit letrar ,,Luigj Gurakuqi".

Edhe pse nxjerrnim dy fletushka, redaksia pothuajse ishte e njejtë. **Buletini** udhëhiqej nga Rufki Suma, ndërsa **Bashkimi** nga Mehmet Ballazhi. E tërë puna ishte vullnetare dhe krijuam një rreth të gjërë aktivistësh. Fletushkat shtypeshin në makinë mekanike shkrimi, ndërsa fotokopjohej në Prishtinë me mjete vullnetare. Shpërndahej dorë në dorë sepse nuk kishte më shumë se 20 ekzemplarë të fletushkave. Gjithnjë në kontekst kohor e historik, duke vlerësuar punën që po bënim në mobilizimin e masave popullore për liri, këto gjurmë pune, po i ribotojmë me të vetmin qëllim që të zbardhen ato aktivitete kohore e në anën tjetër ta kuptojmë thellë se rruga e lirisë ishte përplot sakrifica.

Në anën tjetër, kur u arrestova për herë të dytë më 16 mars 1999 nga policia serbe, ky numër i Buletinit kishte rënë në duar të UDB-së në Ferizaj dhe ishte vendosur në Dosjen time politike të hapur që nga dhjetori i vitit 1985 dhe natyrisht kanë zhvilluar hetime edhe rreth këtij shkrimi, për të cilin ua pohova se autori i shkrimit jam unë. Tanimë ishin rrethana lufte, dhe shkrimet e tilla pak kishin peshë, në raport me situatën dramatike që po zhvillohej.

Megjithatë, krahas akuzave të tjera, hetimet u zhvilluan rreth tërë artikullit të botuar e më shumë tek paragrafët e fundit, të cilat UDB-ja i cilësonte si thirrje për rezistencë e që në fakt ashtu ishin.


se bashku me deshirat tuaja.
Shqiptarit gjat shekujve kurrë s'i teproi copa e bukës nga sofra, por kurrë s'hoqi dorë nga liria, sepse ai e dinte më mirë se kushdo tjetër se mungesa e bukës don të thotë mungesa e lirisë, prandaj elaborati millosheviqian që në fillim është i dështuar.
Sot më tepër se kurnjëherë më parë, solidariteti popullorë duhet të jetë më i madhë. Familja të ndihmojë familjen, lagja-lagjën, fshati-fshatin, qyteti-qytetin, sepse solidariteti ynë popullorë po e shpartallonë deri në bërthamë elaboratin millosheviqian mu ashtu siq shpartalluan nënat tona heroike, elaboratin fashist të Vaso Qubrilloviqit, ndërsa për plana tjera, Serbisë s'do t'i pramtojë më koha.

Duke i pasur parasysh këto rrethanorë, kësaj radhe, 35 vite më vonë (2026) po e risjellim këtë shkrim të botuar siç thamë edhe më lartë në Buletinin nr.4 të dhjetorit 1991 dhe është një fat i mirë që një pjesë e caktuar e këtyre fletushkave kanë arritur t`i shpëtojnë flakëve të luftës.



BULETINI

ORGAN INFORMATIV I FORUMIT RINOR I LDK-së
HANI I ELEZIT

VITI I | Dhjetor 1991 | Nr.4

Elaborati millosheviqian „Maxhet e zbrazëta" të mposhtet me solidaritetin popullor

Kur sulltanët turq deshën ta bëjnë zap shqiptarinë e Skënderbeut, ndaj popullit shqiptar gatuan dy lloje të luftërave. Atë fizike, dhe tjetrën e cila s'ishte më e lehtë se e para, psikologjike.

Mjafton të përmendim Kabanë e Krujës ku ekspeditat aziatike s'lanë gjë pa përdorur, duke filluar që nga bereqeti i [illegible] e deri te gjulet e topave. Po në të njejtën mënyrë edhe karpatistët serbë ndaj kalasë qëndresë të Kosovës sot po ushtrojnë këto dy lloje të luftërave.

Largimi i shqiptarëve nga puna s'është gjë tjetër pos largimi i shqiptarëve nga buka me qëllim që në Kosovë të krijojnë një situatë të rëndë fukaralleku ku shqiptari (sipas mërdëve) s'do të ketë më kohë të merret më me çështjen kombëtare, por me erën e ëmbël të bukës.

Ata që e bënë planin për "maxhet e zbrazëta" le ta dinë se të njejtin planë prej jush e kemi përjetuar fill pas 1945-ës me "otkupin" tuaj famkeq ku nën vellon e "barazisë sociale", shqiptarëve ua zbraznin maxhet me të vetmin qëllim që në mungesë të bukës të shpërngulen nga vatrat e tyre shekullore, e Kosova të popullzohej me kolon serbë, por siq e patë edhe vet plani i juaj i "otkupit" ra në ujë së bashku me dëshirat tuaja.

Shqiptarit gjat shekujve kurrë s'i teproi copa e bukës nga sofra, por kurrë s'hoqi dorë nga liria, sepse ai e dinte më mirë se kushdo tjetër se mungesa e bukës [illegible] të thotë mungesa e lirisë, prandaj elaborati milloshevicjian që në fillim është i dështuar.

Sot më tepër se kurrnjëherë më parë, solidariteti popullorë duhet të jetë më i madh. Familja të ndihmojë familjen, lagja-lagjën, fshati-fshatin, qyteti-qytetin, sepse solidariteti ynë popullor po e shpartallonë deri në bërthamë elaboratin milloshevicjian mu ashtu siç shpartalluan nënat tona heroike, elaboratin fashist të Vaso Çubrillovigit, ndërsa për plane tjera, Serbia s'do t'i pranojë më kohu.

Faksimil nga shkrimi i botuar në Buletinin nr 4, dhjetor 1991

Shkrimi u botua në faqen ballore të fletushkës, dhe për t`i ikur arrestimeve, morëm vendim që fillimisht shkrimet më të ndjeshme të mos bëhen me emra, por të mbesin redaksionale.

Po çka përmbante shkrimi në fjalë?

Elaborati millosheviqian „Magjet e zbrazëta" të mposhtet me solidaritet popullor

Kur sulltanët turq deshën ta bëjnë zap shqiptarinë e Skënderbeut, ndaj popullit shqiptar gatuan dy lloje të luftërave: atë fizike, dhe tjetrën e cila s`ishte më e lehtë se e para, psikologjike.

Mjafton të përmendim Kalanë e Krujës ku ekspeditat aziatike s`lanë gjë pa përdorur, duke filluar nga bereqeti i arave e deri te gjylet e topave. Po në të njejtën mënyrë edhe karpatistët serb ndaj Kalasë Qëndresë të Kosovës, sot po ushtrojnë këto dy lloje të luftërave.

Largimi i shqiptarëve nga puna s`është gjë tjetër pos largimi i shqiptarëve nga buka me qëllim që në Kosovë të krijojnë një situatë të rëndë fukarallëku ku shqiptari (sipas serbëve) s`do të ketë më kohë të merret me çështjen kombëtare, por me erën e ëmbël të bukës.

Ata që e bënë planin „Magjet e zbrazëta" le ta dinë se të njejtin plan prej jush e kemi përjetuar fill pas 1945-ës me „otkupin" tuaj famëkeq ku nën vellon e „barazisë sociale" shqiptarëve ua zbraznin magjet me të vetmin qëllim që në mungesë të bukës të shpërngulen nga vatrat e tyre shekullore, e Kosova të popullzohej me kolon serbë, por siç e patë edhe vetë, plani i juaj i „otkupit" ra në ujë së bashku me dëshirat tuaja.

Shqiptarit gjatë shekujve kurrë s`i teproi copa e bukës nga sofra, por kurrë s`hoqi dorë nga liria, sepse ai e dinte më mirë se kushdo tjetër se mungesa e bukës don të thotë mungesa e lirisë, prandaj elaborati millosheviqian që në fillim është i dështuar.

Sot më tepër se kurrnjëherë, solidariteti popullorë duhet të jetë më i madhë. Familja të ndihmoj familjen, lagja-lagjen, fshati-fshatin, qyteti-qytetin, sepse solidariteti ynë popullorë po e shpartallon deri në bërthamë elaboratin millosheviqian, mu ashtu siç shpartalluan nënat tona heroike, elaboratin fashist të

Vaso Çubrílloviqít, ndërsa për plane të tjera, Serbísë s`do t`í premtoj koha.

Shaban Çupi, qershor 2026, Paldenicë

Hani i Elezit